

REPubliKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËSI POLIÇAN
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Nr. 32 Prot

Polican, me 03/10/2016

VENDIM

NR. 32 Datë 03/10/2016

"PER EMERIMIN E KESHILLIT TE ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE SE UJESJELLESIT SH.A POLICAN "

Ne zbatim te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerit Tregtare" me ndryshimet perkatese, Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.63 date 21.7.2016 "Per riorganizimin e operatorëve qe ofrojne shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave Të ndotura", Ligjit nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore",

VENDOSA:

1. Te krijohet keshilli i administrimit prane Shoqerise se Ujesjellesit Sh.A Polican me perberje :
 - 1) Znj. Bernarda Kondi e diplomuar ne studimet e larta universitare dhe zoteruese e diplomës në shkencat ekonomike .
 - 2) Znj.Luljeta Xhaja e diplomuar ne studimet e larta universitare dhe zoteruese e diplomës DIND në shkencen juridike me eksperience pune 6 (gjashte)vjet .

Ne zbatim te pikes 2 te nenit 12 te VKM nr.63 dt 21.7.2016 ne perberje te KA eshte dhe Administratori i shoqerise se Ujesjellesit Sh.A Polican Z. Klajd Brahimi.

2. Antaret e Keshillit te Administrimit emërohen me mandat 3 (tre) vjecare me te drejte rizgjedhje , me kontratë pune bazuar ne kriteret e qarta performance qe pritet të arrijë cdo anëtar i Keshillit të Administrimit në terma vjetorë sipas Objektivave për performancën (indiktorët) te vendosur në kontratë.

3. Paga bruto e antareve te Keshillit te Administrimit do te jete ne vleren 40 000 (Dyzete mije leke/muaj).

4. Marredheniet juridike dhe financiare ne zbatim te ketij vendimi fillojne me date 03.10.2016.

5.Me ndjekjen e procedurave ligjore per kryerjen e veprimeve prane sporteve te QKR-se ngarkohet administratori i shoqerise, dhe drejtoria juridike dhe menaxhimit te burimeve njerezore prane bashkise Polican.

6.Ky vendim hyne ne fuqi menjehere dhe i shtrin efektet financiare me date 03.10.2016.

KRYETARI I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
KRYETARI BASHKISE
ADRIATIK ZOTKAJ



REPubliKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS POLIÇAN SH.A
ASAMBLEJA E PERGJITHESHME

Nr. 34 Prot

Polican me 30.09.2016

VENDIM

Nr. 34 Date 30/09/2016

"PËR SHKARKIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË UJËSJELLËS POLIÇAN SH.A"

Në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" me ndryshimet përkatëse, vendimin e këshillit të ministrave nr.63 dt. 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

VENDOSA:

1. Të shkarkohen antarët e këshillit mbikëqyrës pranë Ujësjiellës Polican Sh.A me përbërjen si më poshtë:
 1. Memli Kasapi, Kryetar i këshillit mbikëqyrës
 2. Luljeta Xhaja, Zv/Kryetare e këshillit mbikëqyrës
 3. Mimoza Llapë, Antare e këshillit mbikëqyrës
 4. Refat Braho, Antar i këshillit mbikëqyrës
 5. Fadil Kapllani, Antar i këshillit mbikëqyrës
 6. Erjon Zylyflari, Antar i këshillit mbikëqyrës
2. Me ndjekjen e procedurave ligjore për kryerjen e veprimeve pranë sporteve të QKR-së ngarkohet administratori i shoqërisë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjehere.

KRYETARI I ASAMBLESE SE PERGJITHESHME
ADRIATIK ZOTKAJ



REPubliKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËSI POLIÇAN
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Nr. 38 Prot

Polican, me 03.10.2016

VENDIM

NR. 38 Datë 03.10.2016

"PER MIRATIMIN E STATUTIT TIP TE SHOQERISE SE UJESJELLESIT SH.A POLICAN "

Ne zbatim te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerit Tregtare" me ndryshimet perkatese, Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.63 date 27.1.2016 "Per riorganizimin e operatorëve qe ofrojne shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave Të ndotura", Ligjit nr.139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" me cilesin e kryetarit te e asambles se pergjithshme ne mbledhjen e radhes se asambles se pergjithshme ne kuader te riorganizimit te ujesjellesit Sh.a Polican

VENDOSA:

1. Te miratohet Statutin Tip te Shoqerise se Ujesjellesit Sh.A Polican ne permbajtje dhe forme konforme Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.63 date 27.01.2016 .
2. Per zbatimin e ketij statuti ngarkohet asambleja e pergjithshme, keshilli i administrimit, eksperti kontabel, administratori i shoqerise se bashku me stafin e shoqerise.
3. Statuti i shoqerise i bashkelidhet ketij vendimi ne numer total 13 flete .
- 4.Ky vendim hyne ne fuqi menjehere .

KRYETARI I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
KRYETARI BASHKISE
ADRIATIK ZOTKAJ





SHA UJESJELLES POLIÇAN
ASAMBLEJA

VENDIM

Dt. 20.10.2011

Bazuar në statutin për shoqëritë anonime të ujësjellës-kanalizimeve, VKM Nr. 678, datë 03.10.2007, mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Aksionarëve të SHA Ujësjellës Poliçan, zhvilluar në selinë e kësaj shoqërie në datën 20.10.2011, ora 10⁰⁰,

VENDOSI :

I. Miratimi i Këshillit Mbikqyrës të “Ujësjellësi” sha Poliçan, si më poshtë :

- 1) Memli Kasapi
- 2) Refat Braho
- 3) Luljeta Xhaja
- 4) Mimoza Llapi
- 5) Erjon Zylyftari
- 6) Fadil Kapllani

Kohëzgjatja e mandatit është nga data 20.10.2011 deri 19.10.2014.

II. Bazuar në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ngarkohet Drejtori i shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”.

ANETAR I ASAMBLESE
NOVRUZ LLANGO

ANETAR I ASAMBLESE
SULEJMAN BERVISHI

KRYETARI I ASAMBLESE SE AKSIONAREVE
SHA UJESJELLES POLIÇAN
ADRIATIK ZOTKAJ





SHA UJESJELLES POLIÇAN
KESHILLI MBIKQYRES

VENDIM

Dt. 16. 11. 2011

Bazuar në statutin për shoqëritë anonime të ujësjellës-kanalizimeve, VKM Nr. 678, datë 03.10.2007, dhe nenin 158 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Këshilli Mbikqyrës i SHA Ujësjetllës Poliçan, në mbledhjen e zhvilluar në selinë e kësaj shoqërie në datën 16. 11. 2011,

VENDOSI :

Të miratojë ndryshimin në pikën 3 të vendimit të Këshillit Mbikqyrës të SHA Ujësjetllës Poliçan, të datës 31.10.2011, si më poshtë :

1. Emërimin e **inxh. Refik Spaho** në detyrën e drejtorit të SHA Ujësjetllës Poliçan.
2. Paga mujore e drejtorit të SHA Ujësjetllës Poliçan do të jetë 72 000 (shtatëdhjetedymijë) lekë.
3. Drejtori emërohet për një periudhë kohe prej 3 vjetësh, por mbi baza kontratash të rinovueshme vjetore.

Këshilli Mbikqyrës

Memli Kasapi

Luljeta Xhaja

Refat Braho

Fadil Kapllani

Erjon Zylyftari

Mimoza Llapi



**SHA UJESJELLES POLIÇAN
ASAMBLEJA**

INFORMACION PER QKR

Dt. 16. 11. 2011


Në lidhje me “Vendim për pezullimin e aplikimit”, datë 15.11.2011, saktësojmë si më poshtë :
Asambleja e SHA Ujësjetlës Poliçan përbëhet nga përfaqësuesit, si më poshtë :

1. Për bashkinë Poliçan, z. Adriatik Zotkaj, Kryetar i Bashkisë Poliçan, i cili përfaqson 78.3 % të aksioneve, pajisur me vendimin e Këshillit Bashkiak Poliçan Nr. 23, datë 26.09.2011.
2. Për komunën Bogovë, z. Novruz Llango, i cili përfaqson 20.8 % të aksioneve, pajisur me vendimin e Këshillit Komunal Bogovë Nr. 23, datë 07.10.2011.
3. Për komunën Vëndreshë, z. Sulejman Dervishi, i cili përfaqson 0.8 % të aksioneve, pajisur me vendimin e Këshillit Komunal Vëndreshë Nr. 18, datë 30.09.2011.

Kryetari i Asamblesë
Adriatik Zotkaj

Sekretari i Asamblesë
Nertila Kapllani





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMUNA BOGOVE
SKRAPAR

VENDIM
Nr. 231 date 07/10/2011

Keshilli i komunes, i mbledhur sot me 07. 10. 2011, mbasi shqyrtoi materialin me objekt "Miratimin e autorizimit per anetarin e Asanblese se Ujesjellesit Sh.a. Polican", ne mbeshtetje te ligjit nr. 8652 date 31.10.2011 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 germa dh, ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" V.K.M. nr. 660 date 12.09.2007 "Per transferimin e aksioneve te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore", V.K.M nr. 271 date 09.05.1998 "Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore", ndryshuar me V.K.M nr.526 date 21.08.1998 si dhe V.K.M nr. 678 date 03.10.2007

VENDOSI:

Te miratoje autorizimin e perfaqsesit te Komunes Bpgove ne asanblene e Ujesjellesit Sh.a. Polican Keshillit te Komunes z. Novrus Llango.

Vendimi miratohet me vota 11 (njembdhjet) pro, - (-) vota kunder, - (-) abstenim.

SEKRETARI

Arenc MUSABELLIU



KRYETARI

Teki SHAMO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I KOMUNES
VENDRESHE

.....

VENDIM

Nr 18.. Date 30./09/2011

Keshilli i Komunes 1 mbledhur sot me daten 30/09/.....2011, pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike me object "Miratimin e autorizimit per anetarin e asamblese te Ujesjellesit Sh.a.Polican", ne mbeshtetje te ligjit nr 8652 date 31.10.2000" Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore "neni 32 germa dh);ligjit nr.9901 date 14.4.2008 "per tregtaret dhe shoqerite tregtare", VKM nr .660 date 12.9.2007"Per transferimin e aksioneve te shoqerive te ujesjellesave dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore":
VKM nr.271 date 9.5.1998 " Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore"
Ndryshuar me VKM nr 526 date 21.8.1998 si dhe VKM nr.678 date 3.10.2007

VENDOSI

Te miratoje autorizimin e perfaqsesit te Komunes Vendreshe ne asamblene e Sh.a.Ujesjellesit Polican Kryetarin e Komunes z. **Sulejman DERVISHI**

SEKRETAR

Basim Yusem
[Signature]

KRYETAR I KESHILLIT TE KOMUNES

Sulejman Zedri
[Signature]

NR18...PROT
DATE 30./09/...2011



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE
POLIÇAN

V E N D I M

NR.23 Date 26/09/2011

Keshilli I Bashkise , i mbledhur sot ne daten 26/09/2011, pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike me objekt "Miratimin e autorizimit per antarin e asamblese te Ujesjellesit Sh.A Poliçan " , ne mbeshtetje te ligjit nr.8652 date 31.10.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore " neni 32 germa dh); ligjit nr.9901 date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ,VKM nr.660 date 12.9.2007 "Per transferimin e aksioneve te shoqerive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore"; VKM nr.271 date 9.5.1998 "Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore" ndryshuar me VKM nr.526 date 21.8.1998 si dhe VKM nr.678 date 3.10.2007

V E N D O S I:

- Te miratoj autorizimin e perfaqesuesit te Bashkise Polican ne asamblene e Ujesjelles Sh.A Poliçan Kryetarin e Bashkise z.Adriatik Zotkaj.

Vendimi miratohet me vota 11 (njembedhjete) pro , 1 (nje) vote kunder, abstenim ska .

Sekretare
Keshilli Bashkiak
Fiqirete Çela



Kryetare
Keshilli Bashkiak
Marsuela LULAJ

Nr. 600 Prot
Date 27 / 09 / 2011



SHA UJESJELLES POLIÇAN
ASAMBLEJA

VENDIM Nr. 2

Dt. 31.10.2011

Bazuar në statutin për shoqëritë anonime të ujësjellës-kanalizimeve, VKM Nr. 678, datë 03.10.2007, mbledhja e jashtëzakonshme e Asamblesë së Aksionarëve të SHA Ujësjellës Poliçan, zhvilluar në selinë e kësaj shoqërie në datën 31.10.2011, ora 11⁰⁰,

VENDOSI :

- I. Miratimi i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të SHA Ujësjellës Poliçan për vitin ushtrimor 2011.
 - 1) Z. Dhimo Dundo, me licencë profesionale Nr. 8, datë 11.01.2000 dhe me NIPT – K32515098E.
 - 2) Z. Afrim Sula, me licencë profesionale Nr. 4, datë 11.01.2000 dhe me NIPT – K32515099E.
 - 3) Termat e angazhimit për kryerjen e misionit dhe honoraret e shërbimit do të jenë sipas marrveshjes të lidhur me Drejtorin e shoqërisë.
- II. Bazuar në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, **ngarkohet Drejtori i shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit**”.

ANETAR I ASAMBLESE
NOVRUZ LLANGO

ANETAR I ASAMBLESE
SULEJMAN DËRVISHI

KRYETARI I ASAMBLESE SE AKSIONAREVE
SHA UJESJELLES POLIÇAN
ADRIATIK ZOTKAJ





SHA UJESJELLES POLIÇAN
KESHILLI MBIKQYRËS

VENDIM

Dt. 20. 10. 2011

Bazuar në statutin për shoqëritë anonime të ujësjellës-kanalizimeve, VKM Nr. 678, datë 03.10.2007, Këshilli Mbikqyrës i SHA Ujësjellës Poliçan, në mbledhjen e zhvilluar në selinë e kësaj shoqërie në datën 20. 10. 2011.

VENDOSI :

1. **Inxh. Memli Kasapi** të zgjidhet kryetar i Këshillit Mbikqyrës të SHA Ujësjellës Poliçan.
2. **Zo. Luljeta Xhaja (Dehari)**, me profesion juriste, të zgjidhet zëvendëskryetare e Këshillit Mbikqyrës SHA Ujësjellës Poliçan.

Memli Kasapi

Luljeta Xhaja

Refat Braho

Fadil Kapllani

Erjon Zylyftari

Mimoza Llapi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS-KANALIZIME POLIÇAN SH.A
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr 123 Prot

Polican , më 13.09.2019.

VE N D I M

Nr. 22 Datë 13.09.2019

PËR SHKARKIMIN DHE EMERIMIN E ADMINISTRATORIT TË RI TË
SHOQËRISË SË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE SH.A POLIÇAN

Në mbështetje të ligjit nr.9901 datë 10.04.2008 ‘Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare ‘ i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.63 datë 21.07.2016 ‘Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur’, Ligjit nr.139/2015 ‘Për Vetqeverisjen vendore’

V E N D O S A

- 1.Për nevoja të instiucionit, në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të performancës së shoqërisë , të largohet administratori dhe anëtari i këshillit të administrimit të Shoqërisë së Ujësjiellës-Kanalizimeve Polican sh.a Z.Klajd Brahimi dhe në këto pozicion të emërohet Z.Besmir Nezir Doko, me arsim të lartë në shkencat inxhinierike!
2. Administratori i ri Z.Besmir Doko emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetesh, në bazë kontratash të rinovueshme vjetore me Asamblenë e Përgjithshme.
3. Marrdhëniet juridike dhe finaciare në zbatim të këtij vendim fillojnë më datë 13.09.2019
4. Me ndjekjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për kryerjen e veprimeve pranë sporteleve të QKR-së ngarkohet administratori i shoqërisë dhe Departamenti Tregtar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

KRYETARI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
KRYETARI I BASHKISË
ADRIATIK ZOTKAJ

